

ÇËSHTJA E SHËN NAUMIT**DOKUMENTE AMERIKANE – RAPORTE TË LEGATËS
SË SHTETEVE TË BASHKUARA TË AMERIKËS NGA BEOGRADI
E TIRANA LIDHUR ME MARRËVESHJEN SHQIPTARO-SERBE
TË VITIT 1925 PËR SHËN NAUMIN**

Pavarësisht nga vendimi i Konferencës së Ambasadorëve të Fuqive, i 6 dhjetorit 1922, i konfirmuar nga vendimi këshillimdhënës i Gjykatës së Përhershme të drejtësisë ndërkombëtare në Hagë, që përcaktonte më 4 shtator 1924, se Manastiri i Shën Naumit i takonte Shqipërisë, Tirana zyrtare më 18 korrik të vitit 1925, me vendim të parlamentit (42 vota pro e 9 kundër) ia lëshoi këtë vend Mbretërisë Serbo-Kroato-Slllovene duke argumentuar ndër të tjera me kompensim territorial dhe përfitime të tjera. Përfaqësuesit diplomatikë të SHBA në Beograd dhe Tiranë i relatojnë qendrës së tyre në Uashington për këtë çështje. Më poshtë po botojmë korrespondencën që ka të bëjë me çështjen e sipërpërmendur dhe me raportet shqiptaro-jugosllave gjatë viteve 1925-1926.

**Myzafer Bislimi
Irjete Ibrahim**

LEGATA¹ E SHTETEVE TË BASHKUARA TË AMERIKËS

Beograd, 11 mars 1925

Dërgesa No 2606
I Nderuar Sekretar i Shtetit,
Vashington
Zotëri:

Duke iu referuar Dergesës sime No 2591 me 27 të muajit të fundit, lidhur me relacionet mes Jugosllavisë² dhe Shqipërisë kam përmendur (në faqen 2)

¹ *National Archives Washington*, Raporte të Legatës Amerikane në Beograd dhe Tiranë lidhur me Marrëveshjen mes Mbretërisë SKS dhe Shqipërisë të vitit 1925. Raportet janë kopjuar dhe shfrytëzuar nga mikrofilmi pronë e Arkivit Shtetëror të Republikës së Maqedonisë (ASHRM), MF 2031.

² Në dokumentet amerikane në të shumtën e rasteve për Mbretërinë Serbe-Kroato-Slllovene përdoret termi Jugosllavi, edhe pse zyrtarisht në këtë kohë nuk egzistonte një shtet i tillë, sepse shteti quhej Mbretëria e Serbëve-Kroatëve dhe Slllovenëve, ndërsa emrin Mbretëria Jugosllave do ta merrte më 6 janar 1929, kur

negociatat mes tyre për marrëveshjen e kufirit të Shën Naumi. Kam nderin t'ju njohtoj, Juve mes kësaj shkrese me një intervistë për shtypin të dhënë nga z. Spalajkoviç, Ministër Jugosllav në Paris, ku ai shpreh qëndrimin e tij rreth kësaj çështje. Ky qëndrim i thënë forcërisht nga Z. Spalajkoviç, i cili praktikisht është i njëjti me deklaratën që ma kishte dhënë mua kohëve të fundit, mund të konsiderohet se shpreh me saktësi të madhe qëndrimin e qeverisë Jugosllave. Z. Spalajkoviçi, sikurse ç'kam raportuar më parë, është këshilltari kryesor i Nikolla Pashiqit për punët e jashtme dhe shpesh thirret në Beograd për konsultime rreth çështjeve delikate. Sikurse ç'kam raportuar, ai përfillet shpesh edhe si Ministër i Jashtëm i ardhshëm.

Është lënë një periudhë prej një muaji nga Konferenca e Ambasadorëve për të vendosur kontakte direkte për marrëveshje rreth çështjes së Shën Naumit mes Shqipërisë dhe Jugosllavisë dhe ky afat kalon me të 16 e këtij muaji. Pasi nuk ka mundësi praktike që të arrihet marrëveshje para kësaj date, Konferenca do të merret përsëri me këtë çështje. Zgjidhja e kësaj çështje këtu vlersohet se do jetë jo e favorshme për Jugosllavinë, por gjithashtu deklarohet, bile edhe nga Dr. Ninçiq dhe Z. Spalajkoviç, se edhe nëse Konferenca ia jep Shën Naumin Shqipërisë, Jugosllavia kurrë nuk do të pranojë ta dorëzojë atë.

Kam nderin të jem, Zotëri,

Shërbyesi juaj besnik
H. Percival Dodge
Ambasador Amerikan

Shtesë:

1. Përkthim i artikullit nga gazeta "Vreme" (Koha) e Beogradit, 10 mars, 1925.

Dosja No. 710-Pesëfishuar

mbreti Aleksandar Karagjorgjeviç vendosi Diktaturën e 6 Janarit dhe caktoi që emri i shtetit të ishte Mbretëria Jugosllave, emër që ky shtet e mbajti deri në vitin 1941 kur u okupua nga Gjermania. Pas Luftës së II Botërore Jugosllavia u rikrijua mbi baza republikane e federative. Pas shpërbërjes së RSFJ në vitet 90-të termi Jugosllavi mbijetoi deri në vitin 2003, kur dy shtetet e ngelura Serbija dhe Mali i Zi vendosën që më tej të vazhdojnë me emrin Serbi dhe Mali i Zi. Në vitin 2006 Mali i Zi shpalli pavarësinë dhe emri Jugosllavi u shua. Me një fjalë termi Jugosllavi, qarkullonte në diplomacinë europjane e amerikane gjatë gjithë periudhës kur shteti quhej Mbretëria SKS dhe si duket duke e ditur këtë mbreti Aleksandar Karagjorgjeviç vendosi të ndryshojë emrin e shtetit në Jugosllavi, ku në plan të parë ishin interesat nacionaliste serbe për dominim mbi popujt tjerë të shtetit.

LEGATA E SHTETEVE TË BASHKUARA TË AMERIKËS
Beograd, 11 qershor, 1925

Dërgesa No 2709
Konfidencijale
I Nderuar Sekretar i Shtetit,
Vashington.
Zotëri:

Duke u ndërlidhur me Dërgesën time No 2642 të 11 prillit të këtij viti, lidhur me çështjen e Shën Naumit mes Shqipërisë dhe Jugosllavisë, kam nderin t'ju informoj se në një bisedë të fundit me Ministrin e Jashtëm Dr. Ninçiq, lidhur me vendimin e Konferencës së Ambasadorëve, që ia dha Shën Naumin Shqipërisë, ai deklaroi se negociatat do të vazhdojnë mes qeverisë Jugosllave dhe asaj Shqiptare për një zgjidhje miqësore për këtë çështje. Dr. Ninçiq deklaroi se qeveria Britanike nuk do të jetë më aq e vendosur që Manastiri ti takojë Shqipërisë. Tash do të shfrytëzojnë influencën e tyre te Ahmet Bej Zogu ta bindin që të pranojë një shkëmbim të arsyetueshëm. Dr. Ninçiq shpreh bindjen e sigurtë se një shkëmbim i tillë mund të bëhet ndërsa më vonë një shkëmbim i njejtë mund të bëhet për rregullimin e mosmarrëveshjeve të kufirit në Vermosh. Duke folur përgjithësisht për marrëdhëniet mes qeverisë së tij dhe asaj të Ahmet Beut, Dr. Ninçiq duket se është shumë më i kënaqur me marrëdhëniet me Ahmet Beun, se sa në kohën e Dërgesës sime No. 2642 të përmendur më lart. E njoftova atë me vështirësitë që po has Standard Oil Company nga New York rreth marrjes së teritoreve për kërkimin e naftës, por ai nuk tregoi fare interes.

Qeveria Jugosllave pavarësisht nga vendimi i Konferencës së Ambasadorëve do të mbajë edhe më tej qëndrimin e vet rreth Shën Naumit dhe do ta mbajë edhe më tej. Sigurisht se ky qëndrim është tepër significant dhe sigurisht gjat progresit të çështjes Mbreti dhe Mbretresha gjatë vizitës së tyre në Serbinë Jugore vizituan Shën Naumin ku Mbreti iu drejtua murgjëve me një fjalim i cili nuk është publikuar. Vizita u shfrytëzua si rast që edhe një herë ti deklarohet shtypit se Shën Naumi është vendi më i shenjtë në zemrat e të gjithë Serbëve.

Kam nderin të jem, Zotëri,

Shërbyesi juaj besnik
H. Percival Dodge
Ambasador Amerikan

Dosja No. 710-Pesëfishuar

LEGATA E SHTETEVE TË BASHKUARA TË AMERIKËS
Tirana, Shqipëri

No 474

14 korrik, 1925

Konfidencijale

I Nderuar Sekretar i Shtetit,
Vashington.

Zotëri:

Një nga ndërmjetsuesit mes interesave jugosllave në Shqipëri dhe Qeverisë së Tiranës është Xhemail Bej Dino, ish Sekretar i Përgjithshëm i Ministrisë së Punëve të Jashtme. Kam nderin të raportoj se gjatë bisedës së fundit me Xhamail Beun, i cili tani është deputet, ai më deklaroi në konfidencë se Qeveria Shqiptare ka vendosur që të largohet nga pretendimet e saja për Manastirin e Shën Naumit dhe territorin përreth, i cili i ishte dhënë Shqipërisë nga Konferenca e Ambasadorëve.

Ky veprim ishte marrë sipas deklaratës së tij, pasi 1. Mosmarrëveshje preliminare ishin paraqitur me dhënien Shqipërisë të territorit superior në rregjion dhe në luginën e Shën Naumit dhe pikat e tjera të kufirit, (2.) Kompensimi moral dhe miqsor i Jugosllavisë shikohet si një dobi e madhe për Republikën Shqiptare.

Kam nderin të jem, Zotëri,

Shërbyesi juaj besnik
Trojan Kodding

LEGATA E SHTETEVE TË BASHKUARA TË AMERIKËS
Tirana, Shqipëri

No.444

12 maj 1925

Konfidenciale

I nderuar Sekretar i shtetit ,
Vashigton.

Zotëri:

Kam nderin të raportoj se Legata Jugosllave në Tiranë ka pranuar vendimin e Gjykatës të Konferencës së Ambasadorëve për Manastirin e Shën Naumit me rrezignatë të dukshme. Kjo duhej edhe të pritej nga qëndrimet e mëparëshme të z. Branko Llazareviç, ministër Jugosllav, kunat i Ministrit të Jashtëm Ninçiç, i cili pat deklaruar se vendimin për sa i përket Shën Naumit, që e le atë jashtë Shtetit të tij, nuk do të respektohet.

Shqipëtarët pjesërisht kanë zemruar Legatën , Ai thotë, por edhe Beogradi gjithashtu, që të largohen nga pretendimet për Shën Naumin. Për atë do të kopenzohen me katër herë më shumë teritor tjetërkund. Tash Legata

Jugosllave i lejon vetvetes që indinjatën ta shprehë kundër britanikëve, të cilët i konsiderojnë si përgjegjës për suksesin e Shqiptarëve në Konferencën e Ambasadorëve.

Një shpjegim për pozitën e tanishme të Serbisë mundet ndoshta të gjejmë në deklaratën e Lt. Col. W.F. Sterling, këshilltar i Ministrisë së Brendshme dhe Kryeinspektor i rëndësishëm i administratës britanike të Xhandarmerisë Shqiptare. Ky officer është i afërt me Ahmet Bej Zogun dhe deklaroi se kishte ndëgjuar nga burime të besueshme se fqinjët veriorë dhe lindorë nuk do të evakuonin Shën Naumin përderisa Italia nuk evakuon Sazanin, ishull përballë portit të Vlorës. Ministri Britanik, z. H.C.A. Eyres, la të kuptohet se është i interesuar të shohë restaurimin e kufijve Shqiptare të vitit 1913, që don të thotë largim të Italisë nga Sazani.

Kam nderin të jem , Zotëri,

Shërbyes i Juaj besnik,
Trojan Kodding

LEGATA E SHTETEVE TË BASHKUARA TË AMERIKËS

Tirana, Shqipëri

No 1

28 korrik, 1925

I Nderuar Sekretar i Shtetit,
Vashington.

Zotëri:

Në Dërgesën e Legatës No 474 në rreshtin e katërmbëdhjetë është raportuar se Qeveria Shqiptare ndërthurazi ka pranuar të dorëzojë të drejtën e saj mbi Manastirin e Shën Naumit dhe territorin përreth, i cili i ishte dhënë Shqipërisë nga Konferenca e Ambasadorëve. Tash kam nderin të raportoj për një lëvizje tjetër përpara të negociatave shqiptaro-jugosllave dhe veprimin e Parlamentit Shqiptar lidhur me këtë çështje.

Nga sa kam kuptuar propozimi i Qeverisë Jugosllave, me të cilin si duket Qeveria Shqiptare është dakorduar, është si vijon:

(1) Qeveria Shqiptare do të braktisë të gjitha pretendimet e saja për Manastirin e Shën Naumit. Në shkëmbim Jugosllavia do ti japë Shqipërisë fshatin Pishkupi afër Shën Naumit dhe teritorin fqinj të fshatit, që përfshin sipërfaqe 4 herë më të madhe se ai që i është dhënë Shqipërisë nga Konferenca e Ambasadorëve.

(2) Shqipëria gjithashtu do të brektisë pretendimet në një pjesë të malit në Velipojë afër Vermoshit. Në shkëmbim Shqipëria do të merrte Vermoshin dhe dy fshatra fqinj. Gjithashtu shteti fqinj do t'iu mundësojë shqiptarëve që jetojnë në Shqipri të kultivojnë tokat e tyre që ngelin në anën tjetër të kufirit pa patur

nevojë të kenë Passaportë, apo t'i paguajnë ndonjë taksë Jugosllavisë. Shqiptarët nga Kosova Shqiptare dhe Dibra do të kenë të drejtë të tregtojnë në qytetet e Kosovës Jugosllave dhe Dibrës pa paguar kurfarë takse.

Qeveria Shqiptare kërkoi autorizim nga Dhoma e Deputetëve dhe Senati që të realizojë një Marrëveshje sipas asaj që u tha më lart. Pasi që çdo ndrrim i territorit nuk duhet të jetë jasht kushtetutës të dy dhomat u mbledhën bashkë në një session më 18 të këtij muaji (korrik) dhe amenduan Nenin Dy të Kushtetutës i cili thotë: “ Asnjë ndryshim i kufirit nuk do bëhet përveç vendimeve të marra sipas Nenit 141 të Kushtetutës”. Menjëherë pas kësaj Qeveria u autorizua në mënyrë plebishitare të efektuojë një marrëveshje mbi korigjimin e kufirit me Qeverinë Jugosllave me 42 vota pro dhe 9 kundër, konsiderueshëm më shumë se dy të tretat të kërkuara në bazë të Nenit 141 të Kushtetutës.

Kam nderin të jem, Zotëri,
Shërbëtori Juaj besnik,
Nënshkrimi³

LEGATA E SHTETEVE TË BASHKUARA TË AMERIKËS

Beograd, 15 gusht 1925

Dërgesa No 2781
Konfidencijale
I Nderuar Sekretar i Shtetit,
Vashington.
Zotëri:

Kam nderin të raportoj se rregullimi i çështjes së Manastirit të Shën Naumit dhe dhënia e tij Jugosllavisë nga Konferenca e Ambasadorëve është pranuar këtu me një satisfacion të madh. Më duket e nevojshme që prap të përsëris historinë e kësaj mosmarrëveshje të gjatë, por mund të merret e sigurt se elementi serb në Jugosllavi nuk do të pranonte asnjëherë asnjë zgjidhje tjetër përfundimtare. Shtypi lokal karakterizoi këtë vendim jo vetëm shumë të rëndësishëm për vendin, por si rregullimin e mosmarrëveshjes së vetme e cila pengonte një mirëkuptim perfekt mes Jugosllavisë dhe Shqipërisë.

Z. Jovan Markoviç, Ndhmës Ministër i Punëve të Jashtme, së fundi më informoi mua se do të ishte vështirë të më sqaronte mbivlerën dhe rëndësinë shpirtrore që kanë serbët për të patur këtë Shenjtore të vjetër të fesë së tyre kombëtare. Më tej shtoi se alokimi i Manastirit Jugosllavisë me Marrëveshjen e

³ Pason nënshkrimi, i cili është i palexueshëm, nuk ka emër të shënuar.

fundit të kufirit Shqiptaro-Jugosllav te Liqeni i Ohrit, mënjanoi pikën e mosmarrëveshjeve të cilat, sigurisht, do të lenin pasoja dhe komplikime serioze.

Kam nderin të jem, Zotëri,

Shërbyesi juaj besnik,

Gordon Paddock

Ushtrues Detyre i Përkohshëm

Dosja No 715-Pesëfishuar

LEGATA E SHTETEVE TË BASHKUARA TË AMERIKËS

Beograd, 26 tetor, 1925

Dërgesa No 2850

Konfidencijale

I Nderuar Sekretar i Shtetit,

Vashington.

Zotëri:

Duke iu referuar Dergesës No 2781 të 15 gushtit 1925, në lidhje me përmirësimin e marrëdhënieve mes Jugosllavisë dhe Shqipërisë si pasojë e rregullimit të çështjes së Shën Naumit dhe Vermoshit, kam nderin t'ju informoj se ratifikimi i Marrëveshjes nga Parlamenti Shqiptar ishte shkaku i një komunikate për këtë çështje të Press Byrosë Oficijale, e cila theksonte rëndësinë e këtij evenimenti dhe efektet e saj pozitive mbi marrëdhëniet mes dy shteteve. Po e përmbyll përkthimin e kësaj komunikate. Rëndësia e këtij evenimenti është mbivlersuar në artikulin e publikuar në Organin oficijal të Partisë Radikale, "Samouprava", (Vetëqeverisja) dhe në "Vreme" (Koha), që besohet se i reflekton shikimet e Ministrisë të Jashtëm të tashëm, Dr. Ninçiq. Do ti bashkangjis përkthimet e pjesëshme të të dy artikujve.⁴

Në bisedat në Ministrinë e Jashtme dëgjon veç fjalët më të mira për qeverinë e Ahmet Bej Zogut dhe shprehen se po fillon epoka e re e marrëdhënieve të afërta politike dhe ekonomike. Në të njejtën kohë asnjë fjalë për ate që dihej këtu se Ahmed Beu ka financa të pakta dhe se situata e tillë mund të ketë pasoja serioze të njejta për qeverinë e tij sikurse që kishte për parardhësit e tij. Gjithashtu ishte e njohur se Banka Italiane Sindikale, së cilës iu ishte dhënë kontrata për themelimin e Bankës Nacionale Shqiptare, duket se do të vonojë formimin e kësaj banke nga shkaku i kapitalit të përcaktuar. Imzot Fan Noli dhe udhëheqësit e partisë së tij gjithashtu janë aktiv. Imzot Fan Noli është

⁴ Artikullin në gazetën "Vreme" nuk mundëm ta gjejmë në dokumentacionin tonë të shfrytëzuar.

gjentur në Vjenë ku besohet se është takuar me gjeneralin Aleksandar Protugjerov, lider i një pjese të organizatës Maqedonase, i cili atij i kishte premtuar 15 000 komitë (numri pa dyshim është shumë i egzagjeruar) në rast se dëshiron të zhvillojë lëvizje revolucionare kundër Ahmet Zogut. Më vonë u informova nga Ministria e Jashtme se Imzot Fan Noli është zhdukur nga Vjena dhe besohet se tash është në Itali.

Para disa ditësh një ndodhi misterioze ndodhi në Serbinë Jugore, që këtu besohet se ka lidhje me njerëz të cilët dëshirojnë ti rrënojnë marrëdhëniet e mira egzistuese mes Shqipërisë dhe Jugosllavisë. Prefekti i Ohrit z. Blajiq dhe Kryetari i Korit Eklesijal (Kishtar at Ohrit) Arqipeshku Velimiroviç, gjatë udhëtimit të tyre me automobil nga Dibra drejt Ohrit ishin sulmuar nga njerëz të panjohur. Xhandarët të cilët i shoqëronin ishin qëlluar së bashku me shoferin, ishin kidnapuar dhe tërhequr në teritorin shqiptar. Besohet se caku i sulmit dhe kidnapimit ishte Arqipeshku u mirënjohur Nikolaj Velimiroviç, i cili ishte më parë në SHBA, por se ishte fatmirësisht i mbrojtur nga shoqëruesit e tij. Jam i informuar se nuk pritet që incidenti të ketë ndonjë reperkusion politik pasi siç besohet Ahmet Beu do të ofrojë bashkpunim të plotë, në kapjen e agresorëve.

Kam nderin të jem, Zotëri,
Shërbyesi i juaj besnik,
H. Percival Dodge
I Dërguari Amerikan

Shtesë:

1. Përkthim i artikullit nga gazeta Beogradase "Samouprava", 20.tetor 1925;
2. Përkthim i artikullit nga gazeta Beogradase "Vreme", 22, tetor 1925;
3. Përkthim i kumunikesë oficijale të 16 tetorit 1925.

Dosja No.710-Pesëfishuar.

**SHTOJCA No. NË DËRGESËN No.
DATUAR TETOR, 1925**

"Samouprava" 20/10: Çështja e Përcaktimit të Kufirit mes SKS-së dhe Shqipërisë është zgjidhur në mënyrën më të kënaqshme me një Marrëveshje miqsore të akorduar mes dy shteteve fqinje. Kjo provon vullnetin e fortë që kanë të dyja palët që të sigurojnë që marrëdhëniet mes tyre të kenë bazë solide ekonomike dhe politike dhe interes të ndërsjelltë nga të dy shtetet.

LEGATA E SHTETEVE TË BASHKUARA TË AMERIKËS
Beograd, 11 dhjetor, 1925

Dërgesa No 2905
Konfidencijale
I Nderuar Sekretar i Shtetit,
Vashington.
Zotëri:

Si që ju kam informuar në Dërgesën No 2850 të 26 tetorit të këtij viti (1925), që ka të bëjë me marrëdhëniet mes Shqipërisë dhe Jugosllavisë, kam nderin t'ju informoj se gjat dy muajve të fundit këto marrëdhënie kanë vazhduar të përmirësohen. Qeveria jugosllave tash seriozisht është duke u pregaditur që të negociojë disa konventa me Shqipërinë prej të cilave kryesorja është Marrëveshja Tregtare. Një interes të konsiderueshëm duket se është paraqitur nga qarqet e biznesit dhe në mbledhjen e fundit Komiteti Qëndror i Korporatës Industriale ka votuar që ti ndihmojë qeverisë duke mbledhur dhe furnizuar atë me statistika dhe informata tjera të vlefshme për këtë qëllim. Vlen për të theksuar se në përgjithësi Shqipëria është një nga disa shtetet ku industria jugosllave në rritje do ta ketë të mundshme që të konkurojë me sukses prodhimet e jashtme. Në lidhje me këtë unë do të bashkangjis një përkthim të botuar në gazetën "Pravda" të Beogradit para disa ditëve, ku paraqitet situata e tashme e mjerueshme sa i përket shkëmbimit tregtar të Jugosllavisë me Shqipërinë dhe theksohet dëshira, si nga arsyet politike ashtu edhe ato ekonomike, që kjo të përmisohet.

Këtu flitet për një tentim të jugosllavëve që të bëjnë një marrëveshje të mirë dhe të marrin koncesione në miniera dhe bujqësi në Shqipëri por vështirë se kjo mund të realizohet. Në fakt Banka Serbo-Shqiptare, e cila është formuar dy vjet më parë nga disa kapitalistë serbë, ku mund të përmendim Vëllezërit Zuber, më parë të La Ceiba, Honduras, tash duket se është në pozitë të vështirë.

Pasi t'iu bashkangjis këtë, unë do tju informoj edhe në të ardhmen për relacionet jugosllavo-shqiptare

Kam nderin të jem zotëri,
Shërbyesi Juaj besnik

H. Percival Dodge
I dërguar Amerikan

Shtesë:

1. Përkthim nga gazeta e Beogradit "Pravda", 10 dhjetor, 1925.

Dosja, 710-Pesëfishuar
Kopje Legatës në Tiranë.

SHTESA No NË DËRGESËN No
DATUAR 1925

Përkthim

Artikull në gazetën PRAVDA të Beogradit, 10 dhjetor, 1925

MARËDHËNIET ME SHQIPËRINË

Në prag të hapjes së negociatave për tregti me Shqipërinë duhet pjesërisht të theksojmë probleme të cilët përfshijnë elemente të rëndësishme, që nuk janë vetëm të natyrës politike. {shtë gabim nëse e konsiderojmë Shqipërinë si një shtet deficitar nga pikëpamja ekonomike. Bujqësia ka një zhvillim të favorshëm, ndërsa zhvillimi ekonomik i përgjithshëm është i shpejtë. Eksploatimi i planifikuar dhe i arsyeshëm i pyjeve të Mirditës, Shoshit dhe Matit do të kishte benefite të shumta; nuk do të kishte mungesë të forcës puntore për eksploatimin e minierave në të ardhmen. Pavarësia ekonomike e Shqipërisë është megjithatë e kërcënuar nga ekonomia italiane ekspansioniste, dhe së fundmi hapat e saj për penetrim në regjionet e luginës së Vardarit dhe Moravës. Shkëmbimi i tashëm i madh iu pamundëson shteteve të tjera ballkanike t'i rezistojnë gjithë penetrimit të huaj por është lënë një mundësi, një pikë e dobët, që don të thotë Shqipëria. Për më tepër, qendrat e pjesës përfundimtare të Serbisë Jugore, Manastiri, Dibra, Prizreni, etj., ishin në të kaluarën furnizues të tregjeve Shqiptare që nga kohrat më të lashta. Të ndarë nga Shqipëria me kufijt e ri, këto qytete shpresojnë të rikthejnë prosperitetin e tyre tregtar përmes rivendosjes së marrëdhënieve ekonomike me Shqipërinë. Gjithashtu tregtia me portet shqiptare është një element i cili për së afërmi i tangon seriozisht problemet tona të brendshme, restaurimin e Marinës tregtare. Sipas statistikave të tashme ne kemi importuar nga Shqipëria shtatëmbëdhjetë herë më pak se Italia dhe tri herë më pak se Greqia. Kjo është kështu për shkak të kufirit të mbyllur dhe nga procedura e komplikuar e përmbylljes së çështjes kufitare me Shqipërinë. Kjo çështje dhe rirregullimi i rrugës Korçë-Manastir janë lënë pas dore, riparim i cili nuk është më shumë se 15-20 kilometra. Çështja e marrëdhënieve tona me Shqipërinë është njëra pjesë e çështjes së ngatrruar të Adriatikut. Është mjaft qartë të kuptohet rëndësia që Italia i kushton politikës së vet drejt Shqipërisë dhe qëllimet e saja egzakte.

**SHTESË No⁵ NË DËRGESËN No
DATUAR QERSHOR, 1926**

Përkthim

Nga POLITIKA (Independent⁶-Pavarësia) e Beogradit, 10 qershor 1926

ÇKA PO BËN ZOTËRI AHMED ZOGU?

Sjellja e shefit të Shtetit Shqiptar ndaj vendit tonë gjat muajit të fundit është bërë tejet e jashtëzakonshme. Ndërsa një koordinim dhe miqësi të madhe manifeston gjatë raporteve zyrtare mund të vërejmë disa aktivitete të fshehura të cilat janë të drejtuara kundër interesave të shtetit tonë.

Shefi i Shtetit Shqipëtar, i cili si duket ka haruar shërbimet e bëra personalisht atij dhe Shqipërisë, shkel të gjitha konsideratat e bëra si fqinj i mirë dhe hedh vetveten në krahët e të huajve, të cilët nuk brengosen fare për pavarësinë e Shqipërisë apo për rendin në Ballkan.

Zotri Ahmet Zogu ka rinjohur “Komitetin e Kosovës”, duke e spjeguar atë me nevoja të brendshme dhe ka pranuar udhëheqësit e tij. Kështu, “Komiteti i Kosovës” tash ka rifilluar aktivitetin e tij të ndërprerë para dy viteve.

Në vazhdim ja shembujt e fundit të propagandës të agjentëve kosovarë të Zogut: Shtypja dhe shpërndarja e kartolinave mes popullatës në afërsi të kufirit shqiptar, ku paraqiten Ahmet Zogu dhe Cena beu “duke çliruar Prizrenin shqiptar, Gjakovën e pastaj Kosovën” (qytete dhe provincë në Sërbinë Jugore).

Nuk është as e nevojshme për të deklaruar se kjo propagandë është absolutisht e pa kuptimtë, por se është e mirmenduar dhe e realizuar me dijen e

⁵ Ky përkthim i Legatës Amerikane në Beograd, i këtij artikulli të 10 qershorit të vitit 1926 i marrë nga gazeta Beogradase Politika dhe dërguar si i tillë Sekretarit të Shtetit të SHBA-ve ka qenë sigurisht pjesë e ndonjë dërgese të rregullt të Legatës në Beograd, por që për fat të keq nuk jepet numri i dërgesës. Dokumentin sigurisht është pjesë e ndonjë dërgese të dhjetorit të vitit 1926, pasi jepet data e plotë e artikullit, ndërsa numri i dërgesës në kopje nuk mund të lexohet, vendi është i zbrazët.

⁶ Bëhet fjalë për artikull të gazetës Beogradase “Politika” që nga Legata amerikane në Beograd e kanë përkthyer në versionin anglisht në kllapa si Independent që don të thotë në anglisht-Pavarësia, ndërsa përkthimi i Politika në anglisht është gjithashtu Politics dhe në shqip Politika. Nëse nuk është ndonjë lëshim i përkthyesit dhe Legatës, nuk i kemi të njohura arsyet pse është kështu ky përkthim i pasaktë, për atë arsye e kemi dhënë origjinalin në kllapa.

Ahmet Zogut dhe Cena Beut, të cilin Shefi i Shtetit Shqiptar dëshiron ta emërojë si të Dërguar të tij në Beograd

Një fakt tjetër vërteton sjelljen e hapur armiqësore të shefit të Shtetit Shqiptar ndaj shtetit tonë: Ai është suspendimi me urdhër të Ahmet Zogut të nënshkrimit të Marrëveshjes Tregëtare dhe disa konventave me shtetin tonë. Pse është bërë kjo? Ai është sigurisht i vetmi i cili mund ta sqarojë këtë. Megjithëse delegatë shqiptarë kanë zhvilluar negociatat strikt dhe konform instruksioneve të Tiranës. Zemëron edhe fakti se Qeveria Shqiptare ka qenë komplet e informuar për të gjitha kushtet, ndërsa zotëri Zogu stopoi nënshkrimin e Marrëveshjes dhe Konventave, sigurisht nën influencën e disa elementëve të huaj, të cilët e detyruan të formojë “Komitetin e Kosëvës” dhe të cilët kanë krijuar Lëvizjen Fashiste edhe në Shqipëri.⁷

⁷ Këtu autori i tekstit që nuk e dimë se kush është pasi nuk jepet emri i tij, aludon sigurisht për Italinë, por nuk e thotë këtë hapur, dhe sigurisht këtu reflektohet qëndrimi i fshehur i Shtetit të Mbretërisë Serbe-Kroato-Slllovene (SKS).